



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



DPSHTRR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

AUTOMOTIVE **FAIR** ALBANIA

17-19

QERSHOR 2022

Expocity, Tirana



automotivefairalbania.al





RRUGA DREJT EDICIONIT TË PARË TË AUTOMOTIVE FAIR ALBANIA ËSHTË HAPUR ZYRTARISHT!

Takimi i shumëpritur për industrinë e dy dhe katër rrotave, një vitrinë rajonale për sipërmarrjet më novatore në trojet shqipfolëse, po vjen në **Automotive Fair Albania**, në datat **17-19 qershor 2022 në Expocity, Tiranë**. Një seri takimesh që do të shërbejnë si urë ndërlidhëse për mundësi të reja investimi në industrinë e automobilizimit, ndërkohë që eventet e ndryshme do të na afrojnë me pasionin për motorizimin, teknologjinë dhe modernitetin, pa harruar nostalgjinë e mjeteve historike. Rrjeti i operatorëve vendas e ndërkombëtarë, prezantimi i shumë produkteve dhe shërbimeve të ofruara, shikueshmëria në media rajonale e më gjerë dhe pasioni i ngrohtë i publikut janë vetëm disa nga përbërësit e suksesit të këtij panairi,

të cilët i garantojnë një avantazh unik atyre që ekspozojnë në **Automotive Fair Albania**.

Automotive Fair Albania, edicioni i I-rë i panairit automotiv, organizohet për herë të parë në Shqipëri nga Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Mundësi unike për shkëmbim eksperiencash, shikueshmëri, networking dhe bashkëpunime të reja, si dhe një eksperiencë ndërkombëtarizimi që vjen në momentin e duhur!



ZHVILLIMI I SEKTORIT AUTOMOTIV NË RAJON Hi-Tech, Start-Up & Innovation

Mundësi ekskluzive që nuk mbarojnë brenda hapësirave të brendshme e të jashtme të ekspozimit, por shtrihen edhe në hapësira të veçanta, në trajtën e workshop-eve, dëgjësave dhe organizimeve të pandërprera. E gjithë kjo do të zhvillohet në kuadër të rritjes së investimeve të huaja në industrinë e automobilizmit, krahas identifikimit të fushave të novacionit,

zbatimit të shërbimeve të reja dhe zgjidhjeve digjitale.

Automotive Fair Albania do t'i kushtojë vëmendje të veçantë mjeteve elektrike, si protagoniste kryesore të një zhvillimi ekologjik të qëndrueshëm. Sipërmarrësve të rinj do t'u jepet shikueshmëri brenda zonës së *Hi-Tech, Start-Up & Innovation*, hapësirë e dedikuar për evolucionin



teknologjik dhe të rejat e industrisë, por gjithashtu edhe për digjitalizimin e bizneseve. Workshop-et dhe dëgjesat do të përqendrohen në orientime dhe lehtësira, takime me ekspertë të fushave të ndryshme, vendas dhe të huaj, si dhe prezantime biznesesh dhe projektesh. Mjetet shqiptare të koleksionit Retro do të ofrojnë shfaqjen e pazëvendësueshme kulturore dhe historike, ndërsa punishtja

e targave do të përgatisë Targa Suvenir, si një kujtim nga një ditë e këndshme e kaluar në *Automotive Fair Albania*. Aktivitete të ndryshme të sigurisë rrugore, për edukimin e fëmijëve dhe të rinjve, simulime situatash në trafik, car meeting, evente të ndryshme motorsporti e shumë më tepër.



PJESËMARRËS NË AUTOMOTIVE FAIR ALBANIA

Automotive Fair Albania ofron hapësira të shumta dedikuar promovimit të tregut automotiv në rajon për gjatë gjithë fundjavës së panairit. Hapësira e brendshme dhe e jashtme në Expocity do të ndahet sipas kategorive të pjesëmarrësve:

- Ekspozim mjetesh nga kompani dhe koncesionarë automjetesh
- Mjete green, mjete të teknologjive avantguard, mjete rrugore të kontrollit inteligjent
- Prodhues aksesorësh & pjesë automotive nga rajoni
- Kompani për mirëmbajtjen e mjetit me pajisje inovatore dhe sipas teknikave të fundit miqësore ndaj mjedisit
- Mobile Technology: aplikacione mobile për makinë, aksesorë audio, video, remote start, pajisje connectivity
- Transporti publik & lëvizshmëria
- Motorsport & performancë: seksion i dedikuar garave dhe performancës, klubeve të motorsportit dhe produkteve për rritjen e performancës së automjetit, aksesorëve dhe pajisjeve për modifikimet motorike, e shumë më tepër
- RETRO - koleksioni i mjeteve historike, muzeu i pasionit automotiv
- Artizanat automotiv
- Promovimi i Sigurisë rrugore:
 - Kënde edukative për fëmijët dhe të rinjtë
 - Simulatorë për Sigurinë Rrugore
- Infopoint për shërbimet e transportit rrugor, shërbime online
- Shkolla profesionale për përgatitjen e të rinjve për tregun automotiv
- Start-Up: Hi-Tech, Innovation & Automotive Design
- Infrastruktura rrugore dhe institucione shtetërore
- Punishtja e Targave Suvenir
- Meeting/Conference Area
- Infopoint/Recepshion
- Muzikë, argëtim dhe aktivitete motorsport
- Ushqim, pije dhe kafeteri



PROGRAMI I PANAIRIT

17 Qershor
E Premte
Orari: 18:30-22:00

- Ceremonia e hapjes zyrtare të Automotive Fair Albania (me ftesa)
 - Fjalë hyrëse
 - Prezantim i programit dhe aktorëve pjesëmarrës
 - Ekspozim i mjeteve dhe i aktiviteteve pjesëmarrëse
 - Media Moment – Q&A
 - Networking
 - Koktejl, muzikë dhe argëtim
-

18 Qershor
E Shtunë
Orari: 10:00-21:00

- Automoto Park Albania,
 - Career Day kushtuar të rinjve nga shkollat profesionale
 - Meeting B2B
 - Workshops
 - Këndi i Sigurisë Rrugore me aktivitete për fëmijë
 - Transporti publik & lëvizshmëria
 - Carting Slalom
 - Car Meeting
 - Muzikë
 - Intervista
-

19 Qershor
E Diel
Orari: 10:00-21:00

- Evente Motorsporti
 - Go Cart
 - Moto Race
 - Cross Car
 - Slalom
 - Muzikë dhe argëtim
 - Shpallja e çmimeve
-

梅赛德斯-奔驰F 015 Luxury in Motion
The future of autonomous mobility

F 015 Luxury in Motion
The future of autonomous mobility



EXPOCITY
ALBANIA



Automotive Fair Albania do të zhvillohet në ExpoCity, e cila është një nga hapësirat më prestigjioze për organizimin e panairove dhe që ofron infrastrukturë mbështetëse e profesionale për zhvillimin e eventeve në rang rajonal.





HAPËSIRA E BRENDSHME

Në këtë hapësirë, pjesëmarrësit mund të ekspozojnë mjete, produkte ose shërbime inovative për mjetin, pjesë këmbimi ose shërbime mirëmbajtje, hapësira për zhvillimin e workshop-eve, etj.

Tech, Start-Up dhe Inovacion: hapësirë për kreativitet, inovacion dhe sipërmarrës të rinj. Një mundësi unike për realitetet e reja që po hyjnë në botën e automotorizimit. Në këtë zonë të dedikuar do t'i jepet prioritet zhvillimeve teknologjike që i përgjigjen ndryshimeve dhe nevojave të reja, propozimeve nga kompanitë dhe start-ups që ofrojnë produkte apo shërbime inovative. Kjo zonë është një dritare për të ardhmen e transportit dhe lëvizshmërisë.









HAPËSIRA E JASHTME

Hapësirat e jashtme janë një mundësi për vizibilitet të mëtijshëm për ekspozuesit e mjeteve, ku publikut do t'i ofrohen gara, parada dhe shfaqje të mjeteve, ekspozim i mjeteve historike RETRO dhe aktivitete edukative për fëmijë në Këndin e Sigurisë Rrugore.

Një mundësi unike dhe e shumëpritur nga entuziastët për të parë pilotë amatorë dhe profesionistë nga disiplina të ndryshme dhe motorcross. Gjithçka rreth Motosportit, Rally, Offroad, Hillclimb, Go Carting, Cross Car, plot emocione, muzikë dhe argëtim.





KONFERENCË, WORKSHOP, TAKIME B2B

Në përkrahje të zhvillimit të biznesit, investimeve në sektorët prodhues, dhe përmirësimin e politikave fiskale, do të organizohen dëgjesa e do të prezantohen pozitat konkurruese të kompanive eksportuese në rajon (Shqipëri, Kosovë, Maqedonia e Veriut, Serbi, etj.) dhe diskutime mbi problemet me të cilat ballafaqohen gjatë procesit të eksportit të produkteve të tyre.

Në Shqipëri operojnë shumë kompani që merren me prodhimin e pjesëve të ndryshme të këmbimit të automjeteve

dhe furnizojnë me pjesë këmbimi origjinale prodhuesit e huaj të mjeteve si: BMW, Mercedes, Porsche, Volkswagen, Audi, Seat, Skoda, Peugeot, Renault, Maserati, etj.

Për t'u ofruar klientëve shërbime të drejtpërdrejta, kjo mundësohet falë një zinxhiri të shpejtë dhe të besueshëm të furnizimit dhe shërbimeve të specializuara logjistike. Përvoja e kompanive në rajon dhe furnitorët synojnë të përmbushin standardet më të larta për shërbimet që ofrojnë dhe për operacionet e import/eksportit.

Tema diskutimi dhe workshop:

- Mjetet Elektrike & Zhvillimi i Qëndrueshëm
- Teknologji dhe novacion në industrinë e automobilizmit
- Politikat fiskale për mbështetjen e sektorit të mjeteve hibride/ green energy
- E-Transport
- Auto Moto Park Albania
- Regjistrimi i mjeteve me karakter historik, problematikat e hasura në proces.
- Restaurim i mjeteve Vespa
- Mënyra të kursimit të energjisë/ gazeve përmes riciklimit dhe përdorimit të kujdesshëm të mjetit, etj.



Career Day për të rinjtë e arsimit profesional

Kemi kaluar në një fazë tjetër të sipërmarrjeve që krijojnë pozicione pune në vend, ndaj qendrat dhe shkollat e arsimit profesional janë aktorë të tjerë që përfshihen në këto takime, përmes prezantimeve me kompanitë gjatë Career Day, duke u bërë gati për të ridimensionuar tregun e punës me një staf krejtësisht të trajnuar.

- Takime face-to-face dhe intervista me përfaqësues të kompanive, bizneseve dhe institucioneve të interesuara.
- Si të eksplorojnë talentet individuale në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
- Mbështetja dhe know-how i organizatave ndërkombëtare.
- Si të kërkonin për një punë, pasi keni mbaruar arsimin profesional.
- Çfarë ndihme dhe platforme është në ndihmë nga institucionet shtetërore.
- Ide për konkurse dhe angazhim studentor mbi tema automotive dhe mbi Sigurinë Rrugore.





AUTOMOTO PARK ALBANIA

Prezantim i projektit të Automoto Park Albania si një hapësirë ku të gjithë dashamirësit e aventurave në timon mund të testojnë aftësitë e tyre. Automoto Park Albania përbën një hap historik për automotorizimin shqiptar dhe aktivitetet automobilistike, si dhe për promovimin e kulturës së motorsportit. Me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës, ekspertë të FIA, etj. do të diskutohen rrisitë që sjell ky projekt për vendin dhe rajonin. Mund të përmendim: akademi motosporti dhe akademia e edukimit mbi sigurinë

rrugore, poligone profesionale testimi, pistë offroad, qendër eventesh indoor dhe outdoor, muzeu e atelieri RETRO, drag strip me gjatësi 1.2 km në kushte sigurie, autodrom dhe kartodrom i parë i homologuar, etj. Investimi përfshin edhe kompleksin e ri të DRSHTRR Elbasan me Qendrën e re të Kontrollit Teknik (kolaudimi), dedikuar shërbimeve të transportit rrugor.

- Prezantim i projektit
- Hapësirë për Pyetje - Përgjigje





MUZIKË DHE ARGËTIM

Një panair me karakter të tillë kaq pasionant, sigurisht nuk mund t'i mungojë muzika. Do jenë të ftuar DJ të ndryshëm, të cilët do të shoqërojnë eventet e vrullshme me muzikën që i përfaqëson. Po kaq argëtuese janë edhe aktivitetet e parashikuara në kuadër të "Automotive Fair Albania", ku në ambientet e jashtme do organizohen shfaqje garuese me makina dhe motorë, nga klube sportive si "Rally Albania", "Illyrius Moto Sport", "Automobile Club Albania", etj. Ndërkaq për më të vegjlit janë

organizuar një sërë aktiviteteve si: konkurse, kënde lojërash me makina (carting), hapësirë për crafting dhe ekspozim i punëve të tyre kreative mbi tema të kohës, etj. Nuk do të mungojë Këndi Edukativ i "Sigurisë Rrugore", si një aktivitet edukues e zbatimës, ku fëmijët do të kenë mundësi, teksa ngasin biçikletën të mësojnë rregullat bazë të qarkullimit rrugor. Simulimi i një rruge reale, së bashku me sinjalistikat kryesore e të përditshme, janë "skena" ku ndërtohet dhe mësohet nga ambasadorët e sigurisë rrugore.




PROMOVIMI I PANAIRIT

Fokusi kryesor i Automotive Fair Albania është promovimi i tregut automotiv në Shqipëri e në rajon, ndaj një aspekt mjaft i rëndësishëm është promovimi i të gjithë pjesëmarrësve dhe eventeve që do të organizohen përgjatë ditëve të panairit.

- Reklama dhe editoriale (botime të shtypura dhe online)
- Spote në TV dhe në radio
- Fushatë promovionale në mediat sociale
- Promovimi nga të gjithë pjesëmarrësit
- Website tërësisht i dedikuar për panairin:

www.automotivefairalbania.al



KONTAKT

Dëshironi të jeni pjesë e Automotive Fair Albania?

Na kontaktoni:
e-mail: info@automotivefairalbania.al
www.automotivefairalbania.al